

# Bauhaus i Ri Evropian

## Çmimet 2025

### UDHËZUES PËR APLIKANTËT

## 1. BAUHAUS-I I RI EVROPIAN

Bauhaus-i i ri evropian (NEB) është një nismë e politikave dhe financimit të BE-së sipas [Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane](#) që nxit zgjidhje të qëndrueshme për transformimin e mjedisit të ndërtuar dhe stileve të jetesës nën tranzicionin e gjelbër. Ai po kërkon zgjidhje jo vetëm të qëndrueshme, por edhe gjithëpërfshirëse dhe të bukura, duke respektuar diversitetin e vendeve, traditave dhe kulturave në Evropë dhe më gjerë

Duke ndërtuar ura midis prejardhjeve të ndryshme, duke ndarë disiplinat dhe duke bërë të mundur pjesëmarrjen në të gjitha nivelet, Bauhaus-i i Ri Evropian frymëzon lëvizjen për të lehtësuar dhe drejtuar transformimin e shoqërive tona sipas tri vlerave të pandashme:

- **qëndrueshmëria**, nga qëllimet klimatike, qarkullimi, ndotja zero dhe biodiversiteti
- **përfshirja**, nga vlerësimi i larmisë, te sigurimi i qasshmërisë dhe përbalueshmërisë
- **estetika dhe cilësia e përvojës** për njerëzit, përmes dizajnit dhe përfitimeve kulturore

Zgjidhjet e Bauhaus-it të Ri Evropian mishërojnë këto vlera në veprime që **kombinojnë dimensionet lokale, evropiane dhe globale dhe shfrytëzojnë potencialin e qasjeve pjesëmarrëse dhe transdisiplinore**. Përfshirja e palëve lokale të interesit në bashkë-krijimin e projekteve NEB është në qendër të nismës së Bauhaus-it të Ri Evropian.

## 2. ÇMIMET E BAUHAUS-IT TË RI EVROPIAN

Çmimet NEB (Bauhaus-i i Ri Evropian) janë një konkurs i mirëpërcaktuar që shpërblen dhe u jep shikueshmëri projekteve ekzistuese dhe ideve të zhvilluara nga talente të rinj dhe premtues, duke integruar tre vlerat thelbësore të NEB-it dhe parimet e punës (procesi i pjesëmarrjes, angazhimi në shumë nivele, qasja transdisiplinore). Deri më sot, Çmimet kanë marrë më shumë se 5000 aplikime në 4 edicionet (2021, 2022, 2023 dhe 2024), dhe kanë dhënë një total prej **1 545 000 EUR për 72 fitues**.

Çmimet NEB kanë luajtur një rol të rëndësishëm në prezantimin e iniciativës tek qytetarët evropianë dhe ndërtimin e një grupi projektsh frymëzuese. Ky ka qenë një

sukses pasi rajonet, qytetet dhe qytezat po përqafojnë NEB-in me projekte konkrete, disa prej tyre të bashkëfinancuara nga fondet e BE-së. Për më tepër, Çmimet NEB promovojnë pjesëmarrjen e të rinjve dhe dialogun ndërmjet brezave për projekte të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse, duke tërhequr mbi 1700 ide nga të rinjtë në katër vjet.

### 3. EDICIONI 2025 I ÇMIMEVE TË BAUHAUS-IT TË RI EVROPIAN

Çmimet NEB janë të hapura për projekte dhe koncepte të zbatuara në BE, në Ballkanin Perëndimor<sup>1</sup> dhe Ukrainë. Edicioni i pestë i Çmimeve NEB do të kontribuojë në përpjekjet e BE-së për të përmirësuar përbalueshmërinë e banesave duke dhënë katër **“Çmime për Strehimin e Përbalueshëm NEB”** për projektet e përfunduara në BE që ofrojnë zgjidhje të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse, të bukura dhe të përbalueshme për strehim në përputhje me vlerat dhe parimet e NEB-it.

Çmimet 2025 do të jepen në katër kategoritë e mirëpërcaktuara bazuar në akset tematike të transformimit që drejtojnë ofrimin e Bauhaus-it të Ri Evropian<sup>2</sup>:

- **Rilidhja me natyrën**
- **Rikthimi i ndjenjës së përkatësisë**
- **Prioritetizimi i vendeve dhe njerëzve që kanë më shumë nevojë**
- **Formimi i një ekosistemi industrial ciklik dhe mbështetja e të menduarit të ciklit jetësor**

Në secilën nga katër kategoritë, janë krijuar dy fusha paralele të konkurrencës:

- **Kapitulli A: "Kampionët e Bauhaus-it të Ri Evropian"** do t'i kushtohen projekteve ekzistuese dhe të përfunduara me rezultate të qarta dhe pozitive
- **Kapitulli B: "Yjet e Bauhaus-it të Ri Evropian"** do t'i kushtohen koncepteve të paraqitura nga talentë të rinj të moshës 30 vjeç ose më të rinj. Konceptet mund të jenë në faza të ndryshme të zhvillimit, nga idetë me një plan të qartë deri në nivelin e prototipit

Gjithsej **22 çmime** do të jepen në Çmimet 2025:

- Sipas Kapitullit A, 1 fitues dhe 1 nënkampion (vendi i dytë) do të përzgjidhen në secilën kategori nga një juri ekspertësh (d.m.th., 4 fitues dhe 4 nënkampionë)
- Sipas Kapitullit B, 1 fitues dhe 1 nënkampion (vendi i dytë) do të përzgjidhen në secilën kategori nga një juri ekspertësh (d.m.th., 4 fitues dhe 4 nënkampionë)

---

<sup>1</sup>Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova\*, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia.

\* Ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

<sup>2</sup> Kategoritë shprehin vizionin e zhvilluar në [Komunikimin](#) e Komisionit Evropian mbi Bauhaus-in e Ri Evropian, duke u mbështetur nga kontributet e palëve të interesit në fazën e projektimit nga poshtë – lart të nismës.

- Sipas çdo kapitulli, 1 fitues do të përzgjidhet në të gjitha kategoritë nga një votim publik në internet (d.m.th., gjithsej 2 fitues)
- 4 fituesit e “Çmimeve për Strehimin e Përballeshëm NEB” do të përzgjidhen në Kapitullin A, në të gjitha kategoritë nga një juri ekspertësh

## 4. ÇMIMI

Fituesit dhe nënkampionët do të marrin një çmim monetar:

- **30,000EUR** për fituesit e Kampionëve të Bauhaus-it të Ri Evropian (Kapitulli A)
- **15,000EUR** për fituesit e Yjeve në Ngritje të Bauhaus-it të Ri Evropian (Kapitulli B)
- **20,000EUR** për nënkampionët e Kampionëve të Bauhaus-it të Ri Evropian (Kapitulli A)
- **10,000EUR** për nënkampionët e Yjeve në Ngritje të Bauhaus-it të Ri Evropian (Kapitulli B)
- **30,000EUR** për fituesit e 'Strehim i përballeshëm NEB'

Përveç shumës monetare, çdo fitues dhe nënkampion do të përfitojë dhe një paketë komunikimi të ofruar nga Komisioni Evropian (p.sh. promovimi në mediat sociale dhe faqet e internetit të Komisionit Evropian, prodhimi i një videoje të shkurtër dhe mbështetje në promovimin e projekteve).

## 5. KATËR KATEGORITË



### Rilidhja me natyrën

Ne do të shikojmë shembuj frymëzues të projekteve të bukura, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që sjellin individët dhe komunitetet më afër natyrës, që kontribuojnë në rigjenerimin e ekosistemeve natyrore dhe parandalimin e humbjes së biodiversitetit ose i ftojme ata të rishqyrtojnë marrëdhëniet e tyre me natyrën në një perspektivë të përqendruar te jeta, si një alternativë ndaj perspektivës me në qendër njeriun.

Shembujt mund të përfshijnë transformimin fizik të vendeve që tregojnë se si mjedisi i ri, i rinovuar ose i rigjeneruar i ndërtuar dhe hapësirat publike mund të **kontribuojnë në mbrojtjen, restaurimin dhe/ose rigjenerimin e ekosistemeve natyrore** (duke përfshirë ciklet e tokës dhe ujit) dhe **biodiversitetit**. Përdorimi i **zgjdhjeve dhe materialeve të bazuara në natyrë** mund të jetë dimension i rëndësishëm në transformimin fizik.

Transformimi duhet të favorizojë gjithashtu përfshirjen shoqërore, për shembull duke marrë parasysh përballeshmërinë dhe qasshmërinë e vendit, duke përfshirë parimet e projektimit për gjithçka, duke përdorur **ruajtjen dhe restaurimin e mjedisit**, si një detyrë e përbashkët për të gjithë komunitetin dhe të përdorë **zonat e gjelbra si ura lidhëse** ndërmjet hapësirave të përbashkëta nëpër

rrethe të ndryshme. Transformimi duhet të sjellë përfitime të cilësisë së përvojës për komunitetet, për shembull duke marrë parasysh traditat dhe trashëgiminë kulturore lokale dhe nevojat lokale.

Shembujt mund të tregojnë gjithashtu se si ngjarjet, aktivitetet, proceset, produktet mund të **përcjellin një ndjenjë ose një përvojë të të qenit pjesë e natyrës dhe të sjellin një ndryshim të këndvështrimit ndaj natyrës**. Këto mund të jenë iniciativa të lagjes, nga baza e shoqërisë, nisma artistike, festivale, etj.

### Rikthimi i ndjenjës së përkatësisë

2



Ne do të shohim shembuj frymëzues të projekteve të bukura, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që kontribuojnë në sjelljen e ndjenjës së përkatësisë, që i japin "shpirt" ose "kuptim" vendeve, komuniteteve ose produkteve dhe që përkrahin diversitetin.

Shembujt mund të përfshijnë transformimin fizik të vendeve që tregojnë se si mjedisi i ri, i ripërtëritur, i rinovuar ose i rigjeneruar mund të **lidhet me trashëgiminë dhe traditat historike lokale apo me veçori lokale të realiteteve bashkëkohore demografike, dinamike dhe stileve të jetesës kulturore dhe artistike**. Ato gjithashtu mund të ilustrojnë se si proceset rigjeneruese mund të kontribuojnë në **rikthimin e ndjenjës së përkatësisë ose në formësimin e ambicieve të orientuara drejt së ardhmes për komunitetet në nivel lokal ose rajonal**. Ripërdorimi i hapësirave drejt **shkëmbimeve pozitive midis brezave dhe ndërtimit të komunitetit** mund të ketë dimensione të rëndësishme.

Shembujt mund të përfshijnë gjithashtu zhvillimin e produkteve, proceseve ose modeleve të biznesit që **bazohen në kulturën, traditat, njohuritë, zanatet dhe diversitetin dhe krijimtarinë bashkëkohore lokale**. Mund të jetë moda, mobilitet ose dizajni i brendshëm, por edhe ushqimi ose elementë të tjerë të jetës sonë të përditshme që mbartin një ndjenjë përkatësie në shkallë lokale.

### Prioritetizimi i vendeve dhe njerëzve që kanë më shumë nevojë

3



Nevojitet të shohim shembuj frymëzues të projekteve të bukura, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që kontribuojnë në adresimin e nevojave të territoreve, komuniteteve dhe individëve që kanë nevojë për vëmendje të veçantë dhe urgjente për shkak të karakteristikave specifike ekonomike, sociale ose fizike.

Shembujt mund të përfshijnë transformimin fizik dhe rigjenerimin e territoreve dhe vendeve, duke përfshirë fshatrat e vegjël, zonat rurale, qytetet në tkurrje, zonat e rrënuara të qyteteve, zonat e de-industrializuara, vendet që mirëpresin refugjatët ose vendet që aspirojnë të jenë të arritshme për të gjithë. Kjo mund të përfshijë zhvillimin e **projekteve ambicioze sociale dhe të përkohshme të strehimit dhe rikonvertimit, rinovimit, rigjenerimit e ndërtesave dhe rrethinave të tyre për të luftuar segregacionin dhe izolimin**. Shembujt mund të trajtojnë gjithashtu nevoja të

veçanta të grupeve dhe individëve që janë më të prekurit, për shembull, **të larguarit nga konflikti i armatosur, të rrezikuarit nga varfëria, ose të pastrehët.**

Shembujt mund të ilustrojnë gjithashtu se si zbatimi i avancuar i parimit "**projektim për të gjithë**" në transformimin e mjedisit të ndërtuar mund të adresojë çështjet e qasshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të adresojë problematikat e të moshuarve.

Propozime të tjera mund të tregojnë se si **shërbimet komunitare**, mënyrat e reja të bashkimit të komuniteteve të ndryshme (p.sh. mjediset me shumë breza) dhe/ose funksionet e ndryshme (strehim, përfshirje sociale, etj.) së bashku, mund të sjellin **zgjidhje të reja për të adresuar nevojat e veçanta**. Shembujt mund të përfshijnë gjithashtu modele pronësie dhe biznesi, të tilla si **skemat kundër spekulimeve, modelet e bashkëpunimit ose investimet me ndikim**.

### Formimi i një ekosistemi industrial ciklik dhe mbështetja e të menduarit të ciklit jetësor

Ne do të shohim shembuj frymëzues të projekteve të bukura, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që kontribuojnë në transformimin e ekosistemeve industriale drejt praktikave më të qëndrueshme në frymën e qarkullimit, duke marrë parasysh aspektet e përshtatshme shoqërore.

Shembujt mund të përfshijnë transformimin e elementeve të zinxhirëve të vlerave specifike nga marrja e lëndëve të para deri në riciklimin e mbetjeve në ekosisteme të ndryshme, nga **ndërtimi në sektorët e tekstilit dhe stilit të jetesës** (mobilje, dizajn, etj.). Në këtë kuptim, shembuj mund të jenë proceset dhe materialet e reja, **zgjidhjet dhe produktet natyrale me burim të qëndrueshëm**, ose modele të reja biznesi, që sjellin përfitime të qarta në aspektin e qëndrueshmërisë dhe qarkullimit, si dhe në aspektin e cilësisë së jetës dhe dizajnit për të gjithë. Aspektet e përballueshmërisë dhe të përfshirjes shoqërore duhet të integrohen në përputhje me rrethanat.

Shembujt mund të promovojnë modele të reja ekonomike, në veçanti në **ekonominë sociale dhe të zonës dhe të ndikojnë në investime**. Shembujt mund të përfshijnë iniciativa, të cilat nëpërmjet transformimit të ekosistemit apo proceseve industriale kanë kontribuar edhe në zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik të zonës/rajonit. Shembujt mund të përbëhen nga metoda, mjete ose udhëzime, të cilat lehtësojnë (vetë –) vlerësimin e performancës së qarkullimit për lloje të ndryshme të mallrave dhe shërbimeve.

4



## 6. SI TË APLIKONI

Aplikimet për Çmimet e Bauhaus-it të Ri Evropian duhet të dorëzohen përmes platformës së dedikuar për Çmimet NEB dhe duhet të përshkruhen në detaje në formularin përkatës të aplikimit.

Periudha e aplikimit do të fillojë më (14 Janar 2025 dhe do të përfundojë më 14 Shkurt 2025 në orën 19:00<sup>3</sup>).

Aplikacioni duhet të detajojë se si projekti ose koncepti reflekton dhe përkthen **vlerat dhe parimet e punës të Bauhaus-it të Ri Evropian**. Ai gjithashtu duhet të përfshijë elemente që pasqyrojnë **kriteret e përshtatshmërisë dhe të vlerësimit**, të cilat ndryshojnë pak për secilën pjesë (shih më poshtë).

**Çdo aplikim mund të dorëzohet në një kategori dhe vetëm për një kapitull.** Çdo aplikant mund të paraqesë aplikime të shumta për sa kohë që ato lidhen me projekte ose koncepte të ndryshme.

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për “Çmimet për Strehimin e Përballueshëm NEB” duhet të tregojnë në formularin e aplikimit interesin e tyre për të aplikuar për këtë çmim. Vetëm projektet e përfunduara të paraqitura sipas Kapitullit A të vendosura në një nga Shtetet Anëtare të BE-së, që ofrojnë zgjidhje strehimi në përputhje me vlerat dhe parimet e NEB-it janë të pranueshme për këtë çmim.

Jeni të ftuar të ndiqni platformën e çmimeve të Bauhaus-it të Ri Evropian për më shumë informacion dhe përditësime të mëtejshme, dhe mund t'i dërgoni pyetjet tuaja në kutinë postare funksionale të treguar në platformë.

Aplikimet mund të ndryshohen dhe përditësohen ndërsa janë në gjendje drafti. Ju lutemi, mos prisni deri në afatin e fundit për të dorëzuar aplikimin tuaj për të shmangur problemet e minutës së fundit, të tilla si vonesat e ngarkimit të faqeve që mund të ndodhin rreth mbylljes së aplikimeve. Vetëm aplikimet që dorëzohen brenda afatit zyrtar do të shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit.

Për referenca të mëtejshme, aplikantët ftohen të konsultojnë [Manualin NEB](#), i cili përshkruan vlerat dhe parimet e ndryshme të NEB-it dhe përcakton nivele të ndryshme të ambicies.

## 7. KRITERET E PRANUESHMËRISË

Seksioni në vijim ofron shpjegime të hollësishme mbi kriteret e pranueshmërisë për aplikantët dhe për aplikimet. Ju mund të gjeni një tabelë për t'ju ndihmuar në verifikimin e përputhshmërisë tuaj me kriteret e përshtatshmërisë në Shtojën 1.

Të gjithë **aplikantët** për çmimet e Bauhaus-it të Ri Evropian duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

---

<sup>3</sup> Gjatë periudhës së aplikimeve, Komisioni Evropian mund të nxjerrë një vendim për të zgjatur afatin e aplikimit. Një vendim për zgjatjen e afatit komunikohet në faqen e internetit të Çmimeve NEB të vitit 2025.

1. Aplikantët mund të jenë banorë të BE-së ose jo, për sa kohë projektet dhe konceptet e tyre të zbatohen në BE ose në Ballkanin Perëndimor<sup>4</sup>, ose në Ukrainë.
2. Për disa subjekte zbatohen rregulla të veçanta (p.sh. subjektet që i nënshtrohen masave kufizuese të BE-së, sipas nenit 29 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TEU) dhe nenit 215 të Traktatit për Funkcionimin e BE-së (TFEU)<sup>5</sup> dhe subjektet e përfshira në Udhëzimet e Komisionit Nr. 2013/C 205/05<sup>6</sup>). Subjekte të tilla nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në çdo lloj cilësie.
3. Aplikimi duhet të dorëzohet nga:
  - a) **Në Kapitullin A:** individ(ët) ose organizatë(at), (të tilla si qyteti ose rajoni, financuesi, organizatori) që ka(në) të drejtë të përfaqësojë projektin.
  - b) **Në Kapitullin B:** individ(ët) ose organizatë(at), që janë autor(ë) i konceptit. Nëse koncepti ka shumë bashkëautorë të përfshirë në hartimin ose zhvillimin e tij, të gjithë duhet të renditen. Të gjithë aplikantët në këtë fushë duhet të jenë 30 vjeç ose më të rinj në ditën e fundit të thirrjes për aplikime, duke përfshirë të gjithë përfaqësuesit e organizatës të përfshirë në krijimin e konceptit të dhënë.
4. Aplikanti nuk duhet të ndodhet në një ose më shumë nga situatat e përjashtimit të parashikuara në Nenin 136 të Rregullores Financiare<sup>7</sup>.
5. Aplikanti do të mbajë përgjegjësinë e vetme në rast të një pretendimi në lidhje me aktivitetet e kryera në kuadër të konkursit.
6. Duhet të tregohet emri i përfaqësuesit ligjor.

Për më tepër, të gjitha **aplikimet** për çmimin e Bauhaus-it të Ri Evropian duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

7. Aplikimi duhet të dorëzohet nëpërmjet platformës online jo më vonë se data **(14 Shkurt 2025, ora 19:00)**. Gjatë periudhës së aplikimeve, Komisioni Evropian mund të nxjerrë një vendim për të zgatur afatin e aplikimit. Një vendim për zgjatjen e afatit komunikohet në faqen e internetit të Çmimeve NEB të vitit 2025.
8. Aplikimet duhet të dorëzohen në gjuhën angleze.
9. Projektet dhe konceptet e paraqitura nën Kapitujt A dhe B duhet të zbatohen në BE, në Ballkanin Perëndimor ose në Ukrainë. Rregulla të posaçme zbatohen për **“Çmimet për Strehimin e Përballueshëm NEB”**. Ju lutemi shikoni tabelën më poshtë me sqarimet e kriterëve të përshtatshëm.
10. Bashkëpunimi me një ose më shumë vende inkurajohet, megjithëse projekti ose koncepti duhet të zbatohet kryesisht në BE, në Ballkanin Perëndimor ose në Ukrainë. Nëse ka një partneritet, partneri kryesor duhet të identifikohet në aplikim.
11. Aplikantët duhet të tregojnë qartë kategorinë e çmimit dhe kapitullin (A ose B) për të cilin po aplikojnë në formularin e aplikimit.

<sup>4</sup>Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova\*, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia.

\* Ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

<sup>5</sup> Vini re, Gazeta Zyrtare e BE-së përmban listën zyrtare dhe, në rast konflikti, përmbajtja e saj qëndron mbi [Hartën e Sanksioneve të BE](#)

<sup>6</sup> Udhëzimet e Komisionit Nr. [2013/C 205/05](#) mbi pranueshmërinë e subjekteve izraelite dhe aktivitetet e tyre në territoret e pushtuara nga Izraeli që nga qershori 1967 për grante, çmime dhe instrumente financiare të financuara nga BE-ja nga viti 2014 e tutje (OJEU C 205 e 19.07.2013, f. 9-11).

<sup>7</sup> Neni 136, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32018R1046&from=en>

12. Financimi i dyfishtë është rreptësisht i ndaluar. Projektet ose konceptet që kanë marrë një çmim monetar të BE-së nuk mund të marrin pjesë në këtë konkurs. Megjithatë, projektet ose konceptet që kanë marrë tashmë fonde publike, përfshirë nga BE-ja, (p.sh. një grant) janë të pranueshme, për sa kohë që nuk kanë fituar një çmim monetar të BE-së.
13. Aplikimet e pranuar të cilave nuk u është dhënë çmim i Bauhaus-it të Ri Evropian në asnjërin nga kapitujt dhe kategoritë në edicionet e mëparshme mund të ridorëzohen, me kusht që të marrin parasysh kriteret e pranueshmërisë siç përkruhen në këtë Udhëzues për Aplikantët.
14. I njëjti projekt ose koncept nuk mund të paraqitet për disa kategori ose për kapituj të ndryshëm.
15. Aplikantët mund të paraqesin më shumë se një aplikim, por secili duhet të përfaqësojë një projekt ose koncept të ndryshëm në një kategori ose kapitull të ndryshëm (shih pikën 6 më lart). Ndalohet paraqitja e të njëjtit aplikim dy herë. Dorëzimet e shumta të të njëjtit projekt ose koncept sipas kategorive ose kapitujve të ndryshëm do të konsiderohen si të papërshtatshme.
16. Aplikimi duhet të përbëhet nga një formular plotësisht i plotësuar që gjendet në platformën e çmimeve NEB, me të gjitha fushat e detyrueshme të plotësuara. Çdo aplikant duhet gjithashtu të nënshkruajë Deklaratën shoqëruese të Privatësisë.
17. Aplikimi duhet të përfshijë informacionin bazë dhe kreditet për projektin ose konceptin, si dhe:
  - a) Për **Kapitullin A**: të paktën gjashtë fotografi me informacionin e duhur për të drejtën e autorit dhe autorizimin për t'i përdorur ato nga Komisioni Evropian. Nëse fotografitë nuk janë të përshtatshme për përdorim, mund të sigurohen paraqitje të tjera vizuale (p.sh. grafikë, vizatime).
  - b) Për **Kapitullin B**: të paktën një fotografi ose paraqitje vizuale e konceptit me informacion mbi të drejtën e autorit dhe autorizim për t'i përdorur ato nga Komisioni Evropian.
18. Aplikimet duhet të shpjegojnë se si projekti ose koncepti integron dhe promovon vlerat dhe parimet e punës së Bauhaus-it të Ri Evropian dhe se si do të përmirësojë cilësinë e jetës për njerëzit dhe komunitetet në terma afatgjatë.
19. Çdo aplikim duhet të lidhet me një vendndodhje/rajon konkret, të ketë një grup të synuar qartë dhe objektiva të përcaktuara qartë. Ai duhet të shpjegojë se si projekti ose koncepti adreson sfidat specifike me të cilat përballlet lokacioni ose rajoni.
20. Projektet ose konceptet që nuk mund të përsëriten në kontekste të tjera nuk janë të pranueshme. Përshtatshmëria do të thotë që projekti ose koncepti mund të zbatohet ose përshtatet në një vend të ndryshëm nga ku e ka origjinën.
21. Aplikimet duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme të maturimit dhe ecurisë së zbatimit:
  - a) **Projektet në kapitullin A duhet të plotësohen plotësisht në momentin e aplikimit**, pa komponentë që mungojnë (qofshin komponentë fizikë/të prekshëm apo jo materialë). Proceset, mjetet, modelet e biznesit, metodat etj. duhet të jenë zhvilluar plotësisht deri në momentin e aplikimit. Projektet në këtë kapitull duhet të jenë zbatuar ose aplikuar në të paktën një rast specifik.
  - b) **Konceptet në kapitullin B mund të jetë në faza të ndryshme zhvillimi**, duke filluar nga idetë e fazës së hershme deri te prototipet. Aplikantët duhet të



paraqesin një plan zhvillimi, duke detajuar hapat e ardhshëm për zhvillimin e mëtejshëm, promovimin dhe/ose zbatimin e konceptit, me fokus të veçantë në vitin pas aplikimit. Aplikimi duhet të demonstrojë një përkushtim për të sjellë konceptin në jetë.

22. Aplikimet duhet të përfshijnë dokumentacion që pasqyron nivelin e maturitetit dhe progresit:

- a) Për **kapitullin A**, aplikimi duhet të detajojë rezultatet e arritura dhe përfundimet e projekteve të realizuara, p.sh. raporti i vlerësimit, raporti përfundimtar i projektit, certifikimi përkatës etj.
- b) Për **kapitullin B**, aplikimi duhet të përfshijë një plan zhvillimi që përshkruan hapat për zhvillimin dhe zbatimin e mëtejshëm, duke demonstruar një përkushtim për zbatimin e konceptit në praktikë.

### **Sqarimet e kriterëve të përshtatshmërisë për "Çmimet për Strehimin e Përballueshëm NEB":**

- Vetëm aplikantët që paraqesin projekte të vendosura në një Shtet Anëtar të BE-së sipas kapitullit A, që ofrojnë zgjidhje të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të përballueshme për strehim, kanë të drejtë të aplikojnë për "Çmimet për Strehimin e Përballueshëm NEB".
- Aplikantët duhet të tregojnë interesin e tyre për atë çmim kur plotësojnë formularin e aplikimit.
- Aplikimi do të jetë gjithashtu i pranueshëm për të konkurruar në Kapitullin A të konkursit kryesor të Çmimeve NEB 2025, sipas kategorisë në të cilën aplikanti e ka paraqitur aplikimin. Megjithatë, çdo aplikim mund të fitojë vetëm një çmim, - qoftë në konkursin e zakonshëm ose si fitues i "Çmimeve për Strehimin e Përballueshëm NEB". Një projekt nuk mund të marrë të dyja çmimet.

## **8. KRITERET E VLERËSIMIT**

Renditja përfundimtare dhe përzgjedhja e fituesve do të konfirmohet nga Komisioni i Vlerësimit, i përbërë nga Anëtarë të Komisionit Evropian. Ky komision mban përgjegjësi të plotë për të siguruar zhvillimin e duhur të konkursit dhe rezultatet përfundimtare të tij.

Vlerësimi i cilësisë së aplikimeve do të kryhet nga ekspertë të jashtëm dhe të pavarur bazuar në kriteret e dhënies së çmimit të përshkruara më poshtë. Për cilësinë e aplikimit do të jepen maksimumi 100 pikë. Për secilin kriter, kërkohet një rezultat minimal prej 50%. Në listën e finalistëve mund të përfshihen vetëm aplikimet që plotësojnë këtë prag.

### **8.1. Kriteret e dhënies së çmimit për të gjithë kapituajt (A dhe B):**

- a) Karakteri dallues shembullor për sa i përket tri **vlerave thelbësore** të Bauhaus-it të Ri Evropian **(40 / 100 pikë)**:

1. **Qëndrueshmëria:** në kuptimin mjedisor, për shembull, zvogëlimi i ndikimit mjedisor të aktiviteteve njerëzore, avancimi i qarkullimit dhe eko-dizajnit, zbatimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë, parandalimi i humbjes së biodiversitetit, promovimi i aktiviteteve ekonomike që përfshijnë mënyrat e ruajtjes, të menduarit dhe rigjenerimin e ciklit jetësor. Qëndrueshmëria sociale dhe qëndrueshmëria financiare (siç është mirëmbajtja ose financimi i projektit) nuk janë pjesë e këtij kriteri.
  2. **Përfshirja:** në dimensionet e tij të ndryshme, duke filluar nga qasshmëria dhe përbalueshmëria për të gjithë, qeverisja gjithëpërfshirëse dhe projektim për të gjithë. Kjo përfshin festimin e diversitetit, promovimin e shkëmbimeve ndërmjet brezave, adresimin e ndarjes dhe izolimit hapësor, mbështetjen e anëtarëve të cënueshëm të komunitetit dhe rritjen e mundësive për ndërveprim social mes të gjithëve.
  3. **Estetika dhe cilësia e përvojës për njerëzit:** përmes modelimit dhe përfitimeve emocionale/kulturore, për shembull lidhja me cilësitë e një vendi, nxitja e ndjenjës së përkatësisë përmes përvojave kuptimplota ose integrimi i vlerave të reja të qëndrueshme kulturore dhe sociale.
- b) Karakteri dallues shembullor për sa i përket tri **parimeve kryesore të punës të Bauhaus-it të Ri Evropian (35 / 100 pikë):**
1. **Procesi i pjesëmarrjes:** përfshirja e komuniteteve të prekura nga projekti në fazën e bashkë-projektimit, vendimmarrjes dhe zbatimit, fuqizimin e komuniteteve lokale.
  2. **Angazhimi me shumë nivele:** shkëmbim efektiv si horizontalisht – me kolegët – dhe vertikalisht – me të tjerët që veprojnë në shkallë të ndryshme; për të lidhur palët e interesit nga nivele të ndryshme që ndajnë qëllime të ngjashme.
  3. **Qasja transdisiplinore:** angazhim i praktikuesve dhe njohurive nga fusha të ndryshme si dhe duke u mbështetur në njohuritë e joakademikëve dhe publikut.
- c) **Dimensionin novator** në krahasim me praktikën kryesore. **(10 / 100 pikë)**
- d) Potencial i lartë për **transferueshmëri dhe realizueshmëri** (p.sh. të metodologjisë, zgjidhjeve dhe përvojave) në kontekste të ndryshme. **(5 / 100 pikë).**

## 8.2. Kriteret specifike të dhënies së çmimit:

### Për kapitullin A - Kampionët e Bauhaus-it të Ri Evropian:

**Rezultatet, përfundimet ose ndikimi** të demonstruara të projektit në lidhje me objektivat e tij dhe me atë që pritet në kontekstin e kategorisë përkatëse. Këtu përfshihen edhe përfitimet nga projekti për përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Projekti duhet gjithashtu të demonstrojë se si zgjidhjet lokale adresojnë sfidat globale. **(10 / 100 pikë)**

### Për kapitullin B: Yjet e Bauhaus-it të Ri Evropian:

Rëndësia, cilësia dhe besueshmëria e **planit të zhvillimit të konceptit**, me vëmendje të veçantë në hapat e parashikuar në vitin pas aplikimit. Plani duhet të përshkruajë rezultatet dhe përfitimet e pritura si për përfituesit e drejtpërdrejtë dhe ata

të tërthortë. Rezultatet dhe përfitimet duhet të lidhen qartë me objektivat e konceptit dhe pritshmëritë e kategorisë përkatëse. Koncepti duhet të tregojë se si zgjidhjet lokale adresojnë sfidat globale. **(10 / 100 pikë)**

### **8.3. Kriteret plotësuese të dhënies së çmimit**

Duke pasur parasysh renditjen e aplikimeve në bazë të kriterëve të çmimit të listuara më sipër, përzgjedhja përfundimtare nga juria (rekomandimi për fituesit midis finalistëve) do të marrë parasysh kriteret e mëposhtme shtesë:

- (i) diversitetin gjeografik
- (ii) ekuilibrin midis aplikimeve që i referohen transformimit fizik të mjedisit të ndërtuar ('investimet e mëdha') dhe llojeve të tjera të transformimeve ('investimet e vogla')
- (iii) shumëllojshmërinë e konteksteve (rurale/urbane, shkallë e vogël/shkallë më e madhe, etj.).

Për sa i përket diversitetit gjeografik, juria do të sigurojë që asnjë shtet anëtar pjesëmarrës i BE-së, Ballkani Perëndimor ose Ukraina të mos përfaqësohet më shumë se dy herë në mesin e çmimeve në të gjitha kategoritë dhe fushat, duke përfshirë rezultatin nga votimi publik dhe "Çmimet e Veçanta për Strehimin e Përbalueshëm NEB".

## **9. PROCESI I PËRZGJEDHJES**

Procesi i përzgjedhjes së fituesve organizohet dhe shqyrtohet nga një Komision Vlerësimi i përbërë nga përfaqësues të Komisionit Evropian. Komisioni do të sigurojë respektimin e rregullave të zbatueshme, duke përfshirë edhe konfliktin e interesit. Komisioni nuk i vlerëson vetë aplikimet.

Procesi i përzgjedhjes do të realizohet në disa hapa.

### **9.1. Kontrolli i përshtatshmërisë (i planifikuar për Shkurt-Mars 2025)**

Komisioni i Vlerësimit do të shqyrtojë të gjitha aplikimet për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre sipas kriterëve të renditura në pikën 8.

### **9.2. Vlerësimi i cilësisë (i planifikuar për Mars-Prill 2025)**

Ekspertët e jashtëm të përzgjedhur nga shërbimet e Komisionit Evropian do të kryejnë vlerësimin e aplikimeve. Për t'i përzgjedhur këta ekspertë, Komisioni Evropian publikoi një 'Thirrje për Shprehje Interesi' duke kërkuar ekspertë që demonstrojnë ekspertizë përkatëse në lidhje me Bauhaus-in e Ri Evropian (diversitet i balancuar i ekspertizës rreth qëndrueshmërisë, përfshirjes dhe estetikës). Procesi i përzgjedhjes siguroi gjithashtu një përfaqësim të balancuar në aspektin gjinor dhe atë gjeografik. Ekspertët nuk duhet të kenë asnjë lidhje të drejtpërdrejtë ose konflikt të interesit në aplikimet e paraqitura për konkursin e Çmimit të Bauhaus-it të Ri Evropian.

Ekspertët e përzgjedhur do të vlerësojnë aplikimet dhe do t'i atribuojnë pikët bazuar në kriteret e çmimit të përmendura në pikën 8. Çdo aplikim i pranueshëm do të vlerësohet nga dy ekspertë të ndryshëm.

### 9.3. Përcaktimi i listës së finalistëve

**Lista e finalistëve** do të përcaktohet duke përzgjedhur tre aplikimet me pikët më të larta në secilën kategori dhe kapitull për një numër minimal prej 24 finalistësh. Lista e finalistëve do të plotësohet më pas sipas rregullave të mëposhtme:

- **Përfaqësimi gjeografik:** nëse një shtet i caktuar anëtar i BE-së, partner i Ballkanit Perëndimor ose Ukraina nuk përfaqësohet në mostrën e 24 aplikimeve më të mira, projekti i pranueshëm me vlerësimin më të mirë nga ky vend ose vendi partner do t'i shtohet listës së finalistëve.
- **"Çmimet për Strehimin e Përballueshëm NEB":** nëse lista nuk përfshin të paktën gjashtë aplikime të pranueshme për "Çmimet për Strehimin e Përballueshëm NEB", aplikimet e tjera të pranueshme për këtë çmim me pikët më të larta do të shtohen derisa të arrihet minimumi i gjashtë finalistëve.

Këto rregulla zbatohen me kusht që aplikimi(et) me vlerësimin më të lartë të ketë plotësuar të gjitha kriteret e pranueshmërisë dhe të ketë reflektuar cilësinë minimale, të kuptuar si të paktën 50% të pikëve në secilën kategori të dhënies së çmimeve.

Në rast se numri i finalistëve i kalon 50 aplikime, Komisioni i Vlerësimit mund të kryejë një rishikim të plotë të listës së finalistëve, me synimin për ta reduktuar atë në një numër të përputhshëm, në përputhje të plotë me kriteret e mëposhtme:

- (i) rezultatin mesatar që rrjedh nga pikët e atribuara nga dy ekspertët përgjegjës për vlerësimin e cilësisë së aplikacionit të caktuar
- (ii) diversitetin gjeografik
- (iii) ekuilibrin midis aplikimeve që i referohen transformimit fizik të mjedisit të ndërtuar ('investimet e mëdha') dhe llojeve të tjera të transformimeve ('investimet e vogla')
- (iv) shumëllojshmërinë e konteksteve (rurale/urbane, shkallë e vogël/shkallë më e madhe, etj.).

### 9.4. Votimi publik online (i planifikuar për Qershor 2025)

Aplikimet e finalistëve do të publikohen në faqen e internetit të çmimeve NEB për votim publik për të përcaktuar fituesin e votës publike për secilin kapitull (gjithsej 2 fitues). Votimi do të jetë i hapur për të gjithë individët dhe subjektet me një adresë emaili të vlefshme dhe do të zhvillohet përmes një sistemi të sigurt online. Çdo votues do të jetë në gjendje të votojë për dy aplikime për secilin kapitull (secili votues mund të përzgjedhë deri në 4 aplikime). Do të vlerësohet aplikimi i votuar më së shumti për çdo kapitull.

### 9.5. Vlerësimi i jurisë (i planifikuar për Qershor 2025)

Aplikimet e finalistëve do të vlerësohen nga një juri përfundimtare ekspertësh. Këta ekspertë do të zgjidhen për të siguruar një larmi të balancuar ekspertize të tre dimensioneve (qëndrueshmërisë, përfshirjes dhe estetikës), të nismës Bauhaus-i i Ri Evropian. Një ekuilibër gjinor dhe gjeografik do të merret parasysh gjithashtu. Anëtarët do të vërtetojnë gjithashtu mungesën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi në lidhje me ndonjë nga aplikimet finaliste.

Juria përfundimtare do të propozojë 20 projekte dhe koncepte fituese në çdo kategori dhe projekt, duke përfshirë fituesit dhe nënkampionët, si dhe katër fituesit e "Çmimeve për Strehimin e Përballueshëm NEB". Këto vendime do të bazohen në cilësinë e aplikimeve, së bashku me të gjitha kriteret përkatëse plotësuese të specifikuar në kriteret e dhënies së çmimit të përshkruara në pikën 8.

Juria përfundimtare do të funksionojë në bazë të konsensusit. Në rast të divergjencave të vazhdueshme të pikëpamjeve, vendimet mund të merren nga rregull votimit i një shumice të thjeshtë.

## **9.6. Përcaktimi i rezultateve (i planifikuar për Korrik 2025)**

Komisioni i Vlerësimit fillimisht do të kontrollojë rregullsinë e të gjithë procesit, do të shqyrtojë rezultatet e votimit publik dhe propozimin e jurisë dhe do të përcaktojë listën e fituesve të përzgjedhur - 22 fitues gjithsej, përfshirë fitues dhe nënkampionë.

Çdo fitues mund të marrë një çmim vetëm një herë, d.m.th. ose përmes votimit të publikut ose rekomandimit të jurisë. Në rast se ndonjë nga dy fituesit e votimit publik bën pjesë në listën përfundimtare të 20 aplikimeve më të vlerësuara, të propozuara nga juria përfundimtare, ata do të zëvendësohen nga aplikimi i dytë më i vlerësuar në të njëjtin kapitull dhe kategori. E njëjta gjë vlen edhe për "Çmimet për Strehimin e Përballueshëm NEB".

Komisioni Evropian do t'u japë çmimet fituesve të përzgjedhur dhe nënkampionëve bazuar në rekomandimet e Komisionit të Vlerësimit.

## **10. ANULIMI I ÇMIMIT**

Komisioni Evropian mund të anulojë konkursin ose të vendosë të mosakordojë çmimin në ndonjë ose të gjitha kategoritë, pa asnjë detyrim për të kompensuar pjesëmarrësit, nëse: (a) nuk janë dorëzuar aplikime; (b) komisioni i vlerësimit nuk mund të gjejë një fitues në secilën kategori apo kapitull; c) fituesit nuk janë të përshtatshëm ose duhet të përjashtohen.

## **11. TËRHEQJA E ÇMIMIT**

Komisioni Evropian mund të tërheqë çmimin pas dhënies së tij dhe të tërheqë të gjitha pagesat e bëra, nëse zbulon se: (a) është përdorur informacion i rremë, mashtrim ose korrupsion për marrjen e tij; (b) fituesi nuk ishte i përshtatshëm ose duhej të ishte përjashtuar; (c) fituesi ka shkelur detyrimet e tij sipas rregullave të mësipërme të këtij konkursi.